

Gjyqtar Ardian Hajdari

Z. Hajdari është gjyqtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese. Në vitin 1996 ka përfunduar studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë, pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Nga viti 1995 deri në vitin 1998, ka punuar si ndihmësgjyqtar pranë ish-Gjykatës së Shkallës së Parë Malësi e Madhe. Më pas, si pasojë e shkrirjes së Gjykatës së Shkallës së Parë Malësi e Madhe, nga viti 1998 deri në vitin 2000, ka punuar ndihmësgjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka pasur juridiksion edhe për rrethin e Malësisë së Madhe.

Pas marrjes së titullit “Avokat” në qershor të vitit 2000, ka ushtruar profesionin e avokatit deri në qershor të vitit 2017, përveç periudhës kohore nga data 16.11.2000 deri më datë 01.12.2001, gjatë së cilës ka ushtruar detyrën e juristit pranë Hydrocentralit Koman, dhe periudhës kohore nga data 01.10.2005 deri më datë 01.06.2006, gjatë së cilës ka ushtruar detyrën e juristit pranë Bashkisë Vau Dejës.

Z. Hajdari, në përvojën profesionale gjatë eksperiencës së tij të punës, është marrë gjerësisht me sfera të caktuara të së drejtës, si ato penale, civile dhe administrative, me konceptet dhe praktikat më të mira të tyre nëpërmjet ndihmës juridike dhe asistencës ligjore. Si avokat dhe jurist, gjatë periudhës 17-vjeçare (2000-2017), përveçse ka dhënë kontributin më të mirë profesional, ka ndjekur programet e trajnimeve vazhduese për avokatët. Më parë, si ndihmësgjyqtar, gjatë periudhës mes viteve 1995-2000, në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër dhe Malësi e Madhe, z. Hajdari ka gjykuar me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm çështje gjyqësore përgjithësisht civile, administrative dhe familjare.